



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIMIN
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 20587
U. _____ Br. _____

Nr. i faq. 4 Data: 04/07
Br. str. _____ Datum: _____
KAMENICË/A 2022

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



MARRËVESHJE PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

e lidhur ndërmjet:

KOMUNËS SË KAMENICËS

dhe organizatës Jo-Qeveritare:

"Replay Peace"

EMRI I PROJEKTIT / PROGRAMIT:

"VRAPO PËR AUTIZËM 2022"

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje është lidhur në përputhje me nenin 2, i **RREGULLORËS MF - NR -- 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE**

Neni 2 Lënda e marrëveshjes

Lënda e kësaj marrëveshje është mbështetja financiare nga ana e Zyrës së Kryetarit për subvencionim të blerjes sipas kërkesës të paraqitur nga Burim Krasniqi, përfaqësues i OJQ-së, **"Replay Peace"**, me numër të protokollit Sh.02.Nr.17508,dt.07/06/2022 me emër të Kërkesës **"VRAPO PËR AUTIZËM 2022"**

Neni 3 Obligimet e dyanshme

Palët e kësaj kontrate do të obligohen me kushtet e marrëveshjes. Derisa marrëveshja është nënshkruar, secila palë mund të tërhiqet nga marrëveshja pa pasoja financiare.

Neni 3 Vlera e Subvencionimit

1. Vlera e subvencionimit kap shumën prej 300.00 € treqind euro dhe ndahet nga Kodi Buxhetor për Subvencione - **Kodi i Zyrës së Kryetarit –së 16029 dhe paguhet në xhirollogarinë Pro Credit Bank XK051117009314000163.**

2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Autoriteti Kontraktues për Përfituesin.

Neni 4 Obligimet e përfituesit

1. Mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet e paraqitura në kërkesë dhe aplikacion.
2. Përfituesi duhet të raportoj tek Autoriteti Kontraktues mbrenda 30 ditëve pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
3. Përfituesi duhet të sjellë tek Autoriteti Kontraktues:
 - raportin narrativ (shtojca e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
 - raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcën e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
 - kopje të faturave, apo kuponët fiskal
4. Përfituesi duhet të dorëzoj të gjitha kopjet e faturave të paguara apo kuponët tek Autoritetin Kontraktues

5. Përfituesi paguan të gjitha taksat dhe tatimet siq parashihen me ligjet në fuqi
6. Njofton Autoritetin Kontraktues për cdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

Neni 5 **Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

1. Autoriteti Kontraktues obligohet që shumën nga Neni 3 i kësaj marrëveshje t'ia transferoj bartësit të subvencionuar sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje.
2. Shuma nga neni 3 bartet në xhirollogarinë bankare të ofruar nga Përfituesi.
3. Autoriteti Kontraktues mban të drejtën e monitorimit/inspektimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit
4. Autoriteti Kontraktues mban të drejtën e auditimit të qëllimeve të subvencionimit

Neni 6 **Afatet kohore**

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo kontratë është e vlefshme 120 ditë pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 7 **Shkëputja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:

1. Tejkalimit të pa justifikueshëm të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje
2. Marrëveshjes me shkrim nga dyja palët në marrëveshje
3. Shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje, dhe
4. Mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive

Neni 8 **Kthimi i mjeteve**

Në rastet e paraqitura të nenit 7 të kësaj marrëveshje, Përfituesi obligohet që shumën e marrë nga Autoriteti Kontraktues t'ia kthej të njëjtit, dhe atë menjëherë pasi të paraqiten kushtet që përbëjnë arsyeje të marrëveshjes.

Neni 9
Dispozitat tjera

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt/kërkesë, Përfituesi është i obliguar t'i ktheje mjetet e pa shpenzuara tek Autoriteti Kontraktues.

Neni 10
Mosmarrëveshjet

1. Kjo marrëveshje realizohet në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës
2. Çdo mosmarrëveshje ose kontest eventual lidhur me këtë marrëveshje, palët e kësaj marrëveshje do t'i zgjidhin vet, mirëpo nëse këtë nuk mund ta arrijnë, atëherë Gjykata kompetente do të zgjidh ç'do kontest eventual me kërkesë nga secila palë e kësaj marrëveshje.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.


Neni 12

Marrëveshja është përpiluar në 3 kopje të njëjta për secilën palë.

Vendi dhe data:
Kamenicë, 07/06/2022

Për ofruesin e mbështetjes
financiare publike:

KADRI RAHIMAJ
KRYETAR I KOMUNËS SË
KAMENICËS



Për përfituesin:

BURIM KRASNIQI
PËRFAQËSUESE I
"Replay Peace"



Emri, mbiemri, pozita dhe
nënshkrimi i personit të autorizuar